



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 7; 11; 12.2 shkronja d); 17 shkronja s) si dhe nenin 40.2 shkronja h) të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 7; 9 paragrafët 2 dhe 3, nenet 14; 15 paragrafi 2.4; nenin 19 paragrafi 1.19 si dhe nenin 34 paragrafi 2.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2022, mori këtë,

VENDIM PËR SHPALLJEN E z.HALIL KASTRATI “QYTETAR NDERI” I KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

z.Halil Kastrati, i lindur më 17.04.1975, nga Prizreni - Republika e Kosovës, themelues i Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”, shpallet;

“QYTETAR NDERI” I KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 2

Titulli “Qytetar Nderi” i Komunës së Podujevës, për z.Halil Kastratin themelues dhe përfaqësues i Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”, i jepet në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë në fushën e humanizmit në Komunën e Podujevës.

Neni 3

Titulli “Qytetar Nderi” i Komunës së Podujevës sipas këtij Vendimit do të ndahet nga Kryetari i Komunës, i cili autorizohet të përcaktoj formën e dekoratës, mënyrën e dhënies si dhe çështjet tjera sa i përket organizmit dhe solemnitetit të ndarjes së titullit në fjalë për z.Halil Kastratin.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimit përkujdeset Kryetari i Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 dit pas publikimit në ueb faqe zyrtare të komunës

Nr.prot. 01-016/01-0053362/22
Podujevë, datë: 30.06.2022



**Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha**